



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr. 49, datë 13.06.2018

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE
NDAJ SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME DIBËR SH.A.**

Në mbështetje të nenit 23, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar dhe në Raportin nr. 80, datë 11.06.2018, përgatitur nga grupi i inspektimit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

Konstatoi:

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Dibër sh.a. ka detyrime të pashlyera të pagesës rregullatore ndaj Entit Rregullator të Ujit në vlerën 1 412 100 (një milion e katërqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë deri në datën 31.12.2017, të cilat burojnë nga kontrata mes Entit Rregullator të Ujit dhe Ujësjiellës Kanalizime e datës 26.07.2010 e në vazhdim.

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Dibër sh.a nuk zbaton vendimet e ERRU për tarifën. Vendimi për miratimin e tarifave për ujin e pijshëm ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2010 dhe janë të vlefshme deri në miratimin e tarifave të reja, ndërsa vendimi për miratimin e ujërave të ndotur ka hyrë në fuqi në datë 01.07.2014 dhe ka qenë i vlefshëm për një afat kohor të caktuar, deri më 01.07.2015.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën e marrjes së masave administrative ndaj Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Dibër sh.a. për kundërvajtjet administrative:

- a) mospagimi i detyrimeve financiare ndaj Entit Rregullator të Ujit;
- b) për moszbatim të vendimeve të ERRU për tarifat;

2. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Dibër sh.a. ka 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë nga marrja e këtij vendimi për të paraqitur kundërshtimet.

3. Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit ngarkohet të njoftojë Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Dibër sh.a. për vendimin e marrë nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI